

KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr _____ Datë _____ 2012

PËR NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE DHE ADMINISTRIMIN E TYRE NË QYTETIN E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme pasi morri në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e të Ardhurave, bazuar në Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” neni 35 dhe në Ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” Ligjin nr 9920 datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr 24 datë 02.09.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI :

Të miratojë nivelet e mëposhtme të taksave dhe tarifave vendore si më poshtë vijon :

A.TAKSAT VENDORE

Llojet, baza tatimore, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre dhe agjenti tatimor.

1. TAKSA VENDORE MBI BIZNESIN E VOGËL.

Taksa vendore mbi biznesin e vogël llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit, qoftë ky subjekt fizik apo juridik, vendas apo i huaj, që realizon një të ardhur bruto vjetore (qarkullim) më të vogël apo të barabartë me 8.000.000 lekë.

Taksa paguhet në katër kështe të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 Prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 Korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 Tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 Janar e vitit të ardhshëm fiskal.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës vendore mbi biznesin e vogël është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë.

Kategoritë e bazës dhe nivelet e taksës vendore mbi biznesin e vogël paraqiten si më poshtë vijojnë:

Nr	Xhiro/aktivitet	Deri në 2000	NË MIJË LEKË					
			2000 -	3000 -	4000 -	5000 -	6000 -	7000 -
a)	Shitje me pakicë : Çdo njësi tregëtimi bulmet, mish, peshk. Çdo njësi tregëtimi fruta – perime, ushqimore. Çdo njësi tregëtimi artikuj industriale (veshje, parfumeri, argjendari, etj) Bar – Bufe, restorant, pub, diskoteka, kafe – internet, fast – food, lojra fati, etj të ngjashme me to.	27,5	52,8	69,3	85,8	102,3	118,8	135,3
b)	Shitje me shumicë : Magazina dyqane etj të cilat realizojnë shitje me shumicë të artikujve që tregëtojnë.	27,5	52,8	69,3	85,8	102,3	118,8	135,3
c)	Prodhim : Përpunim duralumini, metalesh, druri, tapicerie, letre, kartoni, etj të ngjashme me to. Prodhim tulla, tjegulla, blloqe betoni, furra gëlqereje etj të ngjashme me to. Prodhime me karakter ushqimor si : prodhime buke, ëmbëlsirash, mishi, peshku, bulmeti, pijesh, etj të ngjashme me to. Prodhim konfeksionesh etj të ngjashme me to. Prodhim përpunim produktesh farmaceutike etj të ngjashme me to.	25,3	49,5	66	82,5	99	115,5	132
d)	Shërbime : Riparimi i artikujve elektro shtëpiake, radio televizorë, frigoriferë, lavatriçe, magnetofonë, pajisje fonie etj të ngjashme me to. Shërbime fotokopimi, sallon bukurie, autoservise, kurse për makina (autoshkolla) për traktorë, për kompjuter e për parukeri, agjensi doganore, agjensi këmbimi valutor, agjensi turizmi, motele, pikat e shërbimit të makinave (autoservis), parkim i makinave, lavanteritë, pastrimi kimik, shërbime të rojeve civile, sallat e lojrave të ndryshme (gjimnastikë, aerobi, cirqe, kënde lojrash për fëmijë, pingpong etj) etj shërbime të ngjashme me shërbimet e lartpërmendura.	22	47,3	63,8	80,3	96,8	113,3	129,8
e)	Profesione te lira : Avokat, noter, mjek, mjek laborant, stomatolog, farmacist, ekonomist kontabël të miratuar, ekspert kontabël të autorizuar, mësues, veteriner, agronom, botues, inxhinier, arkitekt, projektues, etj profesione të lira të cilat ushtrohen në njësi fikse apo ambiente të ndryshme. Galeritë e artit të piktoreve, skulptorëve dhe artistëve të tjerë që prodhojnë dhe tregëtojnë objekte artistike. Institucionet jopublike të edukimit	33	58,3	74,8	91,3	107,8	124,3	140,8

	(shkollat, kopshtet apo çerdhet), shërbimet në klinika të specialiteteve të ndryshme mjekësore, shërbimet në laboratorët e diagnostifikimit etj në rastet kur nuk e kalojnë kufirin e kalimit në T.V.SH.							
f)	Ambulant: Subjekte që nuk kanë vendndodhje fikse si shitësit e akulloreve, pijeve freskuese, gazetave, revistave, bananeve, zbukurimeve artistike, veshmbathjeve, ilustraxhinjve etj të kësaj natyre Tregëtia ambulante në tregje publike të miratuar nga njësia e qeverisjes vendore dhe tregjet private.	5,5						
g)	Transport							
1)	Transport pasagjerësh							
	Automjet deri 5 vende	19,25	-	-	-	-	-	-
	Automjet 6-9 vende	38,5	-	-	-	-	-	-
	Automjet 10-25 vende	44	-	-	-	-	-	-
	Automjet 26-42 vende	49,5						
	Automjet mbi 42 vende	52,8						
2)	Transport Mallrash		-	-	-	-	-	-
	Automjet deri 2 tonë	30,8	-	-	-	-	-	-
	Automjet 2-5 tonë	44	-	-	-	-	-	-
	Automjet 5-10 tonë	52,8	-	-	-	-	-	-
	Automjet 10-16 tonë	55	-	-	-	-	-	-
	Automjet mbi 16 tonë	82,5	-	-	-	-	-	-
3)	Transport Ujor							
	Transport detar brenda vendit	60,5	-	-	-	-	-	-
	Transport në liqene brenda vendit	52,8	-	-	-	-	-	-
	Varka për shëtitje	16,5	-	-	-	-	-	-

- Për individët **studentë** të cilët janë diplomuar në vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2011 dhe gjatë vitit 2012, që do të hapin një aktivitet biznes i vogël në territorin e Bashkisë Korçë, gjatë periudhës **01.01.2012 – 31.12.2012**, për periudhën e vitit 2012 gjatë së cilës do të ushtrojnë aktivitet, do të paguajnë **30%** më pak të taksës vendore të biznesit të vogël.
- Për individët që do të hapin aktivitet me objekt **turizmin si Bed & Breakfast, Agjensi Turistike, autobus turistik – city tour, restorante të mirëfillta si dhe agjensi organizimi eventesh të ndryshme festive**, gjatë periudhës **01.01.2012 – 31.12.2012**, për periudhën e vitit 2012 gjatë së cilës do të ushtrojnë aktivitet, do të paguajnë **30%** më pak të taksës vendore të biznesit të vogël.
- Bizneset që do të hapen në kuadrin e **projektit Shërbime Punësimi për të rinjtë** (Young Entrepreneur Service), gjatë periudhës **01.01.2012 – 31.12.2012**, për periudhën e vitit 2012 gjatë së cilës do të ushtrojnë aktivitet, do të paguajnë **30%** më pak të taksës vendore të biznesit të vogël.
- Bizneset që do të hapen në kuadrin e **projektit të UNICEF – it** (personat që janë në skemën e ndihmës ekonomike dhe do të hapin një aktivitet privat) gjatë periudhës **01.01.2012 – 31.12.2012**, për periudhën e vitit 2012 gjatë së cilës do të ushtrojnë aktivitet, do të paguajnë **30%** më pak të taksës vendore të biznesit të vogël.
- Subjektet e biznesit të vogël si bare, restorante, internet kafe, butik dhe laborator fotografik, që bëhen pjesë e projektit **PRO STUDENT**, për vitin ushtrimor 2012 do të paguajnë **20%** më pak të taksës vendore të biznesit të vogël.
- Subjektet e biznesit të vogël që do të paguajnë të plotë vlerën e detyrimit për taksën vendore për vitin në vazhdim brenda datës **31 Mars** do të paguajnë **5%** më pak të taksës vendore të biznesit të vogël.

2. TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME.

Në këtë zë përfshihen **Taksa mbi ndërtesën** dhe **Taksa mbi tokën bujqësore**.

2.a Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor.

Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e së drejtës së pronësisë.

Baza e kësaj takse është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi e taksapaguesit përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë këtë pronësi. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori minimale të bazës për taksën mbi ndërtesën janë si vijon :

Kategoritë minimale të ndërtesave	Lekë/m ² në vit
I . Ndërtesa banimi	
- ndërtuar para 1993 – it	10
- ndërtuar gjatë dhe pas 1993 – it	12
II. Ndërtesa për ushtrim aktiviteti me qëllim përfitimi	
- për tregëti dhe shërbime	150
- ndërtesa prodhimi	
- ndërtesa për shërbime shëndetësore, artizanale, social kulturore, arsimore shkencore	
- ndërtesa për shërbime tregëtare, administrative, etj	
- të tjera (të gjitha ndërtesat që nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme)	
Të tjera :	30
- Ndërtesat në pronësi ose në përdorim të organizatave jofitimprurëse, fondacioneve.	
- Objekte të amortizuara, të dëmtuara dhe jashtë funksionit, si dhe sipërfaqe objektesh të pashfrytëzuara ku nuk zhvillohet aktivitet.	

Për ato kategori ndërtesash banimi të cilat janë të regjistruara si seli të

subjekteve tregëtare, Taksa e Pasurisë për llogaritet dhe paguhet si Kategoria II “Ndërtesa për ushtrim aktiviteti me qëllim përfitimi”, për atë pjesë të sipërfaqes së ndërtesës në të cilën ushtrohet veprimtaria tregëtare, duke u përjashtuar nga Kategoria I “Ndërtesa Banimi”.

2.b Taksa mbi tokën bujqësore.

Taksa mbi tokën bujqësore është detyrim vjetor. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës në hektarë, në pronësi të taksa pagesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë atë. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon :

Klasifikimi sipas kategorisë së tokës bujqësore	Vlera e taksës në lekë/hektar/vit
I	4200
II	3500
III	2800
IV	2300
V	1900
VI	1600
VII-X	1400

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesën dhe taksën mbi tokën bujqësore është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë. Për sa i përket kategorisë “çdo familje” për vitin 2012 detyrimi vjetor fiks deri në nivelin 1.200 (një mijë e dyqind) lek do të shpërndahet për periudhën janar 2012 – nëntor 2012

të vitit 2012 dhe do të paguhet së bashku me faturën mujore të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, pranë sporteleve të Ujësjetllës Kanalizime Korçë.

3. TAKSA E FJETJES NË HOTEL.

Niveli i taksës është **5%** e çmimit të fjetjes për person ose për dhomë, për një natë. Me **“hotel”** kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë.

4. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA.

Baza e taksës është vlera në lek e investimit të ri që kërkohet të kryhet. Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Niveli i taksës sipas zonave është :

ZONA “A” ME RRJET INXHINIERIK MË TË KONSOLIDUAR

- Për banesat kolektive dhe objektet që nuk përfshihen në kategoritë e tjera, niveli i kësaj takse është **3%**.
- Për objektet administrative & shërbimi, niveli i kësaj takse është **2%**.
- Për objektet për qëllime publike si kopshte, çerdhe, shkolla, spitale qofshin këto publike apo private, niveli i kësaj takse është **1%**.
- Për ndërtimet në infrastrukturë si rrugë, ujësjetllës, kanalizime, ndriçim publik, telefon (të gjitha këto publike), niveli i kësaj takse është **1%**.
- Për banesat individuale, niveli i kësaj takse është **1%**.

ZONA “B” ME RRJET INXHINIERIK MË PAK TË KONSOLIDUAR

- Për banesat kolektive dhe objektet që nuk përfshihen në kategoritë e tjera, niveli i kësaj takse është **2%**.
- Për objektet administrative & shërbimi, niveli i kësaj takse është **1,5%**.
- Për objektet për qëllime publike si kopshte, çerdhe, shkolla, spitale qofshin këto publike apo private, niveli i kësaj takse është **1%**.
- Për ndërtimet në infrastrukturë si rrugë, ujësjetllës, kanalizime, ndriçim publik, telefon (të gjitha këto publike), niveli i kësaj takse është **1%**.
- Për banesat individuale, niveli i kësaj takse është **1%**.

ZONA “C” ME RRJET INXHINIERIK TË PA KONSOLIDUAR

- Për banesat kolektive dhe objektet që nuk përfshihen në kategoritë e tjera, niveli i kësaj takse është **1,5%**.
- Për objektet administrative & shërbimi, niveli i kësaj takse është **1%**.
- Për objektet për qëllime publike si kopshte, çerdhe, shkolla, spitale qofshin këto publike apo private, niveli i kësaj takse është **1%**.
- Për ndërtimet në infrastrukturë si rrugë, ujësjetllës, kanalizime, ndriçim publik, telefon (të gjitha këto publike), niveli i kësaj takse është **1%**.
- Për banesat individuale, niveli i kësaj takse është **1%**.
- Për çdo lloj ndërtese, që do të plotësojë kërkesat e programit të Bashkisë Korçë për rritjen e efijencës së energjisë (termoizolim), niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë do të jetë **1%** për të tre zonat e lart përmendura.

Këto përqindje do të llogariten në bazë të vlerës së investimit që do të kryhet sipas kostos mesatare të ndërtimit të Entit Kombëtar të Banesave për vitin përkatës.

4/1 TAKSA NGA NDËRTIMET E REJA PËR STUDIME PROJEKTIVE.

Niveli i taksës është **1%** të vlerës së investimit që do të kryhet sipas kostos mesatare të ndërtimit të Entit Kombëtar të Banesave për vitin përkatës, fond ky i cili depozitohet për llogari të financimit të studimeve urbanistike në pushtetin vendor.

Struktura e ngarkuar për përlogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, taksës nga ndërtimet e reja për studime projekte dhe vjeljen e tyre, është Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit Urban pranë Bashkisë Korçë.

5. TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Kategoritë e ndërtesave, për efekt të bazës së taksueshme, jepen në aneksin 3, që i bashkëlidhet këtij ligji. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitje s së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Vjelja e kësaj takse bëhet nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agentit të taksave, përfitojnë 3 për qind të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhit për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë ose të komunës, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

6. TAKSA VJETORE E MJETEVE TË PËRDORURA.

Drejtoritë rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR), të cilat janë agent tatimor të mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura, mbledhin këtë taksë dhe e derdhin, brenda datës 30 të çdo muaji, për llogari të organeve tatimore të administratës qendrore dhe njërive të qeverisjes vendore.

Drejtoria rajonale e shërbimeve të transportit rrugor i ndan të ardhurat nga taksa e mjeteve të përdorura sipas njërive të qeverisjes vendore, mbështetur në vendbanimin (komunë, bashki) të taksapaguesit që zotëron mjetin e transportit.

Nga shuma e përgjithshme e të ardhurave mujore të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura, drejtoritë rajonale të DRSHTRR-së, pasi mbajnë komisionin prej 5 (pesë)% të totalit mujor të të ardhurave, derdhin me anë të faturës për arkëtim, 18 (tetëmbëdhjetë)% të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, ku është njëzia e qeverisjes vendore, dhe 82 (tetëdhjetë e dy)% të të ardhurave, DPSHTRR-ja e derdh për llogari të drejtorisë rajonale, ku është regjistruar (drejtoria rajonale e tatimpaguesve të mëdhenj).

Rakordimi i pagesës së taksës ndërmjet strukturave të DRSHTRR-së me organet tatimore të administratës qendrore dhe vendore kryhet në bazë të regjistrit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është i përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

7. TAKSA PËR ZËNIEN E HAPËSIRAVE PUBLIKE.

Baza e taksës për zëniën e hapësirave publike është sipërfaqja në metër katror e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si

detyrim mujor i taksa paguesit duke shumëzuar bazën e taksës (sipërfaqen) me nivelin tregues të saj. **Niveli i kësaj takse për Bashkinë Korçë është 90 Lekë / m² në muaj.**

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës për zënien e hapësirave publike është Drejtoria e Kontroll Territorit pranë Bashkisë Korçë.

8. TAKSË E PËRKOHSHME PËR LINJAT AJRORE DHE NËNTOKËSORE (TELEFONI, ENERGJI, TV KABLLOR, INTERNET)

Baza e taksës për linjat ajrore dhe nëntokësore është gjatësia lineare për kilometër e linjave ajrore dhe nëntokësore e cila vihet në shfrytëzim nga subjekte për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim vjetor i taksa paguesit duke shumëzuar bazën e taksës (gjatësinë lineare për kilometër) me nivelin tregues të saj. **Niveli i kësaj takse për Bashkinë Korçë është 1.000 lek/km/vit për linjat nëntokësore dhe 2.000 lek/km/vit për linjat ajrore.**

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së përkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore është Drejtoria e Kontroll Territorit pranë Bashkisë Korçë.

9. TAKSA E TABELËS.

Kjo taksë aplikohet për të gjitha subjektet fizike, juridike, private e shtetërore, vendas apo të huaj që kryejnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Bashkisë Korçë me përjashtim të tregëtareve ambulantë të cilët janë të përjashtuar, për arsye se nuk kanë detyrim për ta vendosur atë. Baza dhe niveli i kësaj takse përcaktohet nga Këshilli i Bashkisë.

Niveli i kësaj takse për Bashkinë Korçë është si më poshtë vijon :

a) Tabelë për qëllime identifikimi, pavarësisht nga sipërfaqja, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë. 120 lekë/vit

b) Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim. 120 lekë/vit

c) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj. 1.000 lekë/m²/ditë

Detyrimi për taksën e tabelës është vjetor. Afati i pagesës është brenda datës 31 mars të vitit fiskal për subjektet e regjistruara dhe për subjektet e reja në momentin kur lind detyrimi.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së tabelës është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Korçë.

9. DHËNIE AUTORIZIMI PËR PIKAT E TREGËTIMIT ME PAKICË TË KARBURANTEVE DHE NJËSITË E SHITJES SË LENDËVE DJEGËSE DHE BOMBOLAVE TË GAZIT

Bazuar në Ligjin Nr.8450, datë 24.2.1999 “PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGËTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE” të ndryshuar me Ligjin Nr .9218, datë 08.04.2004 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8450, DATË 24.2.1999 “PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGËTIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 129, datë 18.03.1999 “PËR PROÇEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E LEJEVE E TË AUTORIZIMEVE PËR TREGËTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT E TË

NËNPRODUKTEVE TË TYRE” të ndryshuar me Vendimet e Këshillit të Ministrave Nr. 170, datë 25.04.2002 & Nr. 563, datë 27.08.2004 “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME PËR PROÇEDURAT DHE KUSHTET PËR DHËNIEN E LEJEVE E TË AUTORIZIMEVE PËR TREGËTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT E TË NËNPRODUKTEVE TË TYRE”, Bashkia Korçë jep autorizime për personat juridikë apo fizikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregëtimin e karburanteve për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lëndëve djegëse (njësitë e shitjes së lëndëve djegëse) në territorin e Bashkisë Korçë. Autorizimet jepen nga Bashkia Korçë **për një periudhë deri në 5 (pesë) vjet** me të drejtë përsëritjeje dhe pagesa për dhënie autorizimi për dy kategoritë e mësipërme është si më poshtë vijon :

* Pagesë për dhënie autorizimi për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës për automjete dhe vajra lubrifikante **100.000 lekë.**

* Pagesë për dhënie autorizimi për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit të lëngshëm të naftës **50.000 lekë.**

Struktura e ngarkuar për dhënie e këtij autorizimi është Qendra e Liçensimit pranë Drejtorisë së Kontrollit të Territorit të Bashkisë Korçë.

B. TARIFAT VENDORE

I.	LLOJI I TARIFËS	VLERA
1.	TARIFË REGJISTRIMI (PËR LEJE USHTRIMI VEPRIMTARIE EKONOMIKE) <ul style="list-style-type: none"> - Për persona juridikë, shtetërorë & privatë, vendas & të huaj, biznes i vogël apo i madh - Për persona fizikë vendas & të huaj biznes i madh - Për persona fizikë vendas & të huaj biznes i vogël - Për persona fizikë që bëjnë tregëti dhe kryejnë shërbime ambulante - Për persona që do të hapin aktivitet artizanat gjatë vitit 2012 si gurgëdhëndës, hekurpunues, riparime rrobaqepsie, punime artistike dore etj si këto - Për persona studentë të diplomuar në Universitetin “Fan Stilian Noli” Korçë në vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2011 dhe gjatë vitit 2012 do të hapin aktivitet gjatë vitit 2012. - Për persona studentë të diplomuar jashtë qytetit të Korçës & jashtë Shqipërisë për periudhën 2007 – 2012 dhe që do të kthehen në Korçë për të hapur aktivitet gjatë vitit 2012. - Për persona që do të hapin aktivitet që ka lidhje me teknologjitë e informacionit gjatë vitit 2012 si tregëtim & riparim kompjutera, kurse për mësimin e kompjuterit, salla interneti etj si këto - Për persona që do të hapin aktivitet çerdhe, kopshte, shkolla, kurse për mësimin e gjuhëve të huaja, librari, terrene sportive, kënde lojnash për fëmijë, qendra për të moshuarit, kinema dhe përkujdesje fëmijësh - Për persona që do të hapin aktivitet me objekt turizmin si shtëpi tradicionale që ofrojnë 	<p>20.000 lekë</p> <p>20.000 lekë</p> <p>15.000 lekë</p> <p>2.500 lekë</p> <p>0 lekë</p> <p>0 lekë</p> <p>0 lekë</p> <p>0 lekë</p> <p>0 lekë</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - shërbimin e fjetjes dhe mëngjes, Agjensi Turistike, autobusi shëtitës turistik, lokale me muzikë live, restorante me muzikë tradicionale korçare (serenata) si dhe agjensi organizimi eventesh të ndryshme festive - Bizneset që do të hapen në kuadrin e projektit shërbime punësimi për të rinjtë (Young Entrepreneur Service) - Bizneset që do të hapen në kuadrin e projektit të UNICEF – it 	<p>0 lekë</p> <p>0 lekë</p> <p>0 lekë</p>
2.	<p>TARIFË PËR PASTRIM DHE HEQJE MBETURINASH</p> <ul style="list-style-type: none"> - çdo familje - për konvikte, pensione, shtëpi pushimi, spitale, martenitete • shtetërore • private - për mjedise administrative (zyra, salla mbledhjesh) • shtetërore • private - për institucione social – kulturore, sportive, ekspozita & panairë - Për subjektet e ndërtimit seli administrative : • Biznes i madh - Për subjektet e ndërtimit B.V & B.M : • Njësi ndërtimi (për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla, kopshte, objekte banimi kolektive e tregëtare, zyra dhe të tjera të ngjashme me to) • Njësi ndërtimi banesa individuale • rikonstruksion i pjesshëm • rikonstruksione të pjesshme banesa individuale <p>KUR VEPRIMTARIA KLASIFIKOHET ME T.V.SH</p> <ul style="list-style-type: none"> - për njësi tregëtimi, shërbimi e artizanati - për çdo njësi prodhimi - për çdo njësi hoteli, moteli, pikë turistike - për çdo njësi supermarketi Biznes i Madh <p>Për të gjithë subjektet e Biznesit të Vogël shuma e tarifave të pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit nuk duhet të kalojë 10% të nivelit tregues të taksës, sipas tabelës së taksimit të subjekteve të biznesit të vogël.</p> <p>►Tarifa e Pastrimit</p>	<p>1.700 lekë në vit</p> <p>30 lekë vit / dhomë 750 lekë vit / dhomë</p> <p>100 lekë vit / dhomë 750 lekë vit / dhomë</p> <p>10.000 lekë vit / njësi</p> <p>50.000 lekë në vit</p> <p>100.000 lekë / kantier 20.000 lekë / kantier 50.000 lekë / kantier 10.000 lekë / kantier</p> <p>40.000 lekë në vit 70.000 lekë në vit 70.000 lekë në vit 60.000 lekë në vit</p> <p>75% e 10 përqindëshit</p>
3.	<p>TARIFË REKLAME</p> <ul style="list-style-type: none"> - e thjeshtë dhe elektronike 	<p>22.500 lekë/m2/vit deri në sipërfaqen 18 m2. Për sipërfaqe më të mëdha se 18 m2 paguhet 405.000 lekë/vit</p>
4.	<p>TARIFË PARKIMI</p> <ul style="list-style-type: none"> - autovetura taksi 8 + 1 - autovetura taksi 4 + 1 - autobusë - autovetura 	<p>8.000 lekë / vit 4.000 lekë / vit 15.000 lekë / vit;50 lek /orë 1.500 lekë /vit</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - automjet transport malli deri 3,5 T (me ngarkesë) - automjet transport malli mbi 3,5 T (me ngarkesë) - motomjet transport malli (motokarro) - në vendparkime të rezervuara për autovetura dhe motokarro - në vendparkime të rezervuara për automjete transport malli - në vendparkime publike me pagesë <p>Shënim : * Tarifa e parkimit për automjet e transportit të mallit deri dhe mbi 3,5 T (me ngarkesë) gjatë certifikimit të tyre do të paguhet për 5 (pesë) vjet pasi edhe certifikata dhe liçenca jepet për një periudhë 5 vjeçare, kjo sipas udhëzimit nr.11 datë 18.12.2009 të MPPTT – së. Ndërsa për rastet e subjekteve të cilat disponojnë liçenca të lëshuara në periudhat e mëparshme, sipas udhëzimit të mësipërm certifikatat do të lëshohen sipas afatit të vlefshmërisë së liçencës dhe tarifa e parkimit do të llogaritet sipas këtij afati.</p>	<p>2.000 lekë / vit *</p> <p>1.500 lekë / vit *</p> <p>1.500 lekë / vit</p> <p>10 lekë / orë</p> <p>20 lekë / orë</p> <p>50 lekë / orë</p>
5.	<p>TARIFË PËR THERJEN E BAGËTIVE</p> <p>a – Tarifë për therje në thertoren e Bashkisë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjerdhë - Të imta - Derra <p>b – Tarifë për certifikimin në thertoren private</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjerdhë - Të imta - Derra <p>c – Tarifë për certifikimin e mallrave për import – export</p> <ul style="list-style-type: none"> - certifikatë vërtetim për export - certifikatë vërtetim për import - certifikatë vërtetim për kafshë luksi - kafshë dhe shpendë gjahu <p>d - Tarifë për certifikatë për mallra që qarkullojnë brenda vendit (Produkte ushqimore me origjinë shtazore)</p>	<p>500 lekë</p> <p>200 lekë</p> <p>300 lekë</p> <p>200 lekë</p> <p>50 lekë</p> <p>50 lekë</p> <p>3.000 lekë</p> <p>5.000 lekë</p> <p>1.000 lekë</p> <p>1.000 lekë</p> <p>1.000 lekë</p>
6.	TARIFË PËR TAVOLINA JASHTË LOKALEVE	50 lekë/ditë/tavolinë
7.	TARIFË PËR M² MUR TË JASHTËM PËR ÇDO NDËRTESE TË RE	20 lekë
8.	<p>TARIFË PËR SERVITUTIN E KALIMIT NË PRONAT PUBLIKE</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për zonën qendër qyteti dhe bulevardet kryesore <ul style="list-style-type: none"> • rrugë kalimi • hapësirat e tjera - Për zonat e tjera të qytetit <ul style="list-style-type: none"> • rrugë kalimi • hapësirat e tjera 	<p>180 lek/m² në muaj</p> <p>250 lek/m² në muaj</p> <p>150 lek/m² në muaj</p> <p>200 lek/m² në muaj</p>

9.	<p>TARIFË GJELBËRIMI</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Çdo familje</i> 500 lekë në vit - <i>Çdo njësi prodhimi :</i> • Biznes i madh 6.000 lekë në vit - <i>Për subjektet e ndërtimit seli administrative :</i> • Biznes i madh 5.000 lekë në vit - <i>Për subjektet e ndërtimit B.V & B.M :</i> • Njësi ndërtimi (për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla, kopshte, objekte banimi kolektive e tregëtare, zyra dhe të tjera të ngjashme me to) 10.000 lekë / kantier • Njësi ndërtimi banesa individuale 2.000 lekë / kantier • rikonstruksion i pjesshëm 5000 lekë / kantier • rikonstruksione të pjesshme banesa individuale 1000 lekë / kantier - <i>Çdo njësi shërbimi dhe artizanati :</i> • Biznes i madh 5.000 lekë në vit - <i>Profesione të lira :</i> (mjek, mjek laborant, stomatolog, farmacist, klinika e shërbime të tjera mjekësore) • Biznes i madh 5.000 lekë në vit - <i>Profesione të lira :</i> (avokat, noter, ekonomist kontabël të miratuar, ekspert kontabël të autorizuar, botues, inxhinier, arkitekt, projektues, mësues, veteriner, agronom, murator, karpentier, elektrikët etj, profesione të lira të cilat ushtrohen në njësi fikse apo ambiente të ndryshme si dhe galeritë e artit të piktorëve, skulptorëve dhe artistëve të tjerë që prodhojnë dhe tregëtojnë objekte artistike) • Biznes i madh 5.000 lekë në vit - <i>Çdo njësi tregëtimi me shumicë e pakicë, restorante, bar – bufe, pub, diskoteka, lojra fati etj :</i> • Biznes i madh 5.000 lekë në vit - <i>Çdo njësi hoteli, moteli, komplekse turistike :</i> • Biznes i madh 10.000 lekë në vit - <i>Për institucione social – kulturore, sportive, ekspozita, panairë etj :</i> • Biznes i madh 5.000 lekë në vit - <i>Për çdo njësi supermarketi :</i> • Biznes i madh 10.000 lekë në vit - <i>Për institucionet & mjediset administrative shtetërore :</i> 5.000 lekë në vit - <i>Për Partitë politike & shoqatat</i> 2.500 lekë në vit <p>Për të gjithë subjektet e Biznesit të Vogël shumica e tarifave të gjelbërimit, pastrimit dhe ndriçimit nuk duhet të kalojë 10% të nivelit tregues të taksës, sipas tabelës së taksimit të subjekteve të biznesit të vogël. ► Tarifa e Ndriçimit 10% e 10 përqindëshit</p>	
10.	<p>TARIFË PËR PËRDORIM TË TREGUT TË LIRË TË QYTETIT</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Për tregëtim mallra industriale 30 lek/m2/ditë b) Për tregëtim mallra ushqimore, fruta – perime, vezë 40 lek/m2/ditë c) Për tregëtim mish, peshk, bulmet 50 lek/m2/ditë 	

11.	TARIFË PËR EKSPOZIM MALLI JASHTË DYQANIT	30 lek/m2/ ditë
12.	TARIFË DHËNIE LEJE <ul style="list-style-type: none"> • Kantina <ul style="list-style-type: none"> - zona A - zona B • Kënde lojnash 	60 lek/m2/ditë 40 lek/m2/ ditë 40 lek/m2/ditë
